



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 255/Prot.
1

Tiranë, më 05.02.2026

VENDIM

Nr. 24, datë 29.01.2026

**“MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË PROKURORIT PRANVERA
PUSTINA, KANDIDATE PËR POZICIONIN E PROKURORIT NË PROKURORINË E
PËRGJITHSHME”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar (në mungesë)
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar (në mungesë)

Në mbledhjen plenare të datës 29.01.2026, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të prokurorit Pranvera Pustina, candidate për pozicionin e Prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 255 prot., datë 22.01.2026, të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, dëgjoi Relatorin z. Olger Eminaj, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë *(në vijim Këshilli)* është institucioni që garanton pavarësinë dhe statusin e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Me Vendimin nr. 147, datë 27.06.2025, *“Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për procedurën e ngritjes në detyrë në Prokurorinë e Përgjithshme, të shpallura me Vendimin nr. 35, datë 03.03.2025, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe caktimin me short të relatorit për këto procedura”*, Këshilli ka filluar procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për procedurën e ngritjes në detyrë në Prokurorinë e Përgjithshme, të shpallura me Vendimin nr. 35, datë 03.03.2025, të Këshillit, ndër të cilët edhe prokurori Pranvera Pustina.
3. Me të njëjtin vendim është caktuar me short edhe Relatori për procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për procedurën e ngritjes në detyrë në Prokurorinë e Përgjithshme, ndër të cilët edhe prokurori në fjalë. Pas hedhjes së shortit ka rezultuar si Relator përgjegjës për këtë procedurë verifikimi anëtari i Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, z. Olger Eminaj
4. Në zbatim të Pikave 1 dhe 2, të Seksionit B, të Kreut V dhe Seksionit A, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit nr. 171, datë 27.9.2019 *“Për miratimin e Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”*, i ndryshuar (në vijim, Rregullorja), në datë 30.06.2025, Relatori ka njoftuar në rrugë elektronike *(me e-mail)* kandidaten Pranvera Pustina për fillimin e procedurës së verifikimit, si dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit, apo ndonjë anëtari të Këshillit, në rast të ekzistencës së një shtate konflikti interesi.

Në datë 03.07.2025 kandidatja Pranvera Pustina ka konfirmuar marrjen e këtij e-maili dhe faktin, se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë prej anëtarëve të Këshillit.
5. Në vijim, në datë 04.07 2025, përmes e-mailit, kandidates i janë përcjellë, si dhe i është kërkuar plotësimi dhe dorëzimi i Autorizimit për verifikimin e të dhënave personale që lidhen me verifikimin e figurës dhe pasurisë, formularëve dhe deklaratave përkatëse.
6. Në shkresën protokolluar me nr. 1947 Prot, datë 09.07.2025, kandidatja Pranvera Pustina ka depozituar pranë zyrës së Protokollit të Këshillit, Autorizimet dhe Deklaratat standarde për kandidim për pozicionin e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme, me dokumentet si vijon:

1. *Autorizimi datë 09.07.2025, Këshillit të Lartë të Prokurorisë për sigurimin dhe verifikimin e të dhënave personale;*
2. *Deklaratë datë 09.07.2025, me të dhënat mbi adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktet telefonike për njoftim gjatë kësaj procedure;*
3. *Deklaratë datë 09.07.2025, mbi papajtueshmërinë me funksionin e magjistratit për shkak të anëtarësisë në parti politike;*
4. *Deklaratë Individuale datë 09.07.2025, që kandidati nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete;*
5. *Formular Vetëdeklarimi për zbatimin e Ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";*
6. *Formular aplikimi për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta, në zbatim të Ligjit Nr.45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar;*
7. Në mbështetje të neneve 32, pikat 2-7, 48, pikat 7-8, dhe 52, pika 9, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe gurmës "ç", të Kreut II, të Rregullores, Relatori ka ndjekur veprimet proceduriale për verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidates Pranvera Pustina.
8. Pas verifikimeve paraprake dhe përgjigjeve të ardhura nga institucionet përgjegjëse shtetërore, është përgatitur Relacioni me gjetjet paraprake si dhe sugjerimet përkatëse.

II- VERIFIKIMI I PASURISË SË KANDIDATIT

9. Me Shkresën nr. 2055 Prot, datë 17.07.2025, Këshilli i është drejtuar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, për verifikimin e pasurisë për kandidaten, znj. Pranvera Pustina.
10. Me Shkresën nr. 2480/6, datë 12.01.2026 (regjistruar me nr. 2055/1, datë 13.01.2026), të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, *ILDKPKI*) është përcjellë Shkresa nr.159/23 datë 12.01.2026, "Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratave të Interesave Private të subjektit Pranvera Pustina magjistrat, kandidat për Prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme" (gjithsej 28 faqe). Sipas këtij akti përfundimtar kontrolli, në mënyrë të përmbledhur rezulton se, referuar të dhënave të deklarave të pasurisë dhe interesave private, kandidata ka deklaruar deri në datë 24.07.2025, si më poshtë:
 1. *Truall + ndërtesë me sip. 449.49 m2, Mjull-Bathore, Tiranë, blerë në vitin 2024, me çmimin 460 000 euro. Zotëruar nga kandidati dhe b/shorti me 50% secili.*

2. Ullishte me sip. 8 700 m², Mumajes, Tiranë, blerë në periudhën kohore 2016 - 2021, me çmimin 55 000 euro. Zotëruar nga kandidati dhe b/shorti me 50% secili.
3. Llogari rrjedhëse në Credins Bank, në emër të kandidatit, në vlerën 2 083 182 lekë.
4. Llogari rrjedhëse në Credins Bank, në emër të kandidatit, në vlerën 795 446 lekë.
5. Apartament me sip. 210 m², Tiranë, blerë në vitin 2005, me çmim 53 940 euro, Zotëruar nga b/shorti 100%.
6. Apartament me sip 101.47 m², Kavajë, blerë në periudhën 2016 - 2018, me çmim 69 000 euro. Paguar 377 603 lekë për pjesën takuese të parcelës ndërtimore. Zotëruar nga b/shorti 100%.
7. Apartament me sip. 86. 80 m², Tiranë, blerë nga nëna me privatizimin e banesave në vitin 1993, me çmim 22 600 lekë. Zotëruar nga b/shorti 33.33 %.
8. Aksione në shoqërinë "Tashko-Pustina" sh.p.k.. Numri i kuotave 67, Vlera 67 000 lekë. Zotëruar nga b/shorti 45.58 %.
9. Aksione në shoqërinë "Carton Jazz Entertainment" sh.p.k.. Numri i kuotave 1, Vlera 40 000 lekë. Zotëruar nga b/shorti 20 %.
10. Aksione në shoqërinë "DUNAT" sh.p.k.. Numri i kuotave 1 Vlera 100 000 lekë. Zotëruar nga b/shorti 100%.
11. Person fizik "Florian Pustina". Vlera 0 lekë. Zotëruar nga b/shorti 100%.
12. Llogari rrjedhëse në BKT, në emër të b/shortit, në vlerën 12.107 euro.
13. Llogari rrjedhëse në BKT, në emër të b/shortit, në vlerën 334 497 lekë.
14. Llogari kursimi në ISP Bank, në emër të b/shortit, në vlerën 6 054 euro.
15. Llogari rrjedhëse në ISP Bank, në emër të b/shortit, në vlerën 6 267 euro.
16. Llogari krediti në ISP Bank, në emër të b/shortit, në vlerën 29 euro.
17. Llogari kursimi në ISP Bank, në emër të vajzës Mia, në vlerën 103 euro.
18. Llogari kursimi në ISP Bank, në emër të vajzës Mia, në vlerën 593 825 lekë.
19. Llogari kursimi në ISP Bank, në emër të b/shortit, në vlerën 2 941 lekë.
20. Llogari rrjedhëse në BKT Kosovë, në emër të b/shortit, në vlerën 2 356 euro.
21. Huadhënie nga b/shorti për shoqërinë "Tashko-Pustina" sh.p.k., në vlerën 3800 euro.
22. Kriptomonedha të investuara në vlerën 1 000 euro (vlera aktuale 2 344 euro) zotëruar nga b/shorti 100%.
23. Detyrime të kandidatit ndaj klinikës spitalore në Gjermani, në shumën 13 446 euro.
24. Detyrime të kandidatit ndaj të tretëve, ose donacione, për pagesat në klinikën spitalore në Gjermani, në shumën 203.580 euro, të cilat mbeten për tu qartësuar në një kohë të mëvonshme.
25. Kartë krediti të b/shortit në ISP Bank, me gjendje detyrimi 2 056 euro.
26. Kartë krediti të b/shortit në BKT, me gjendje detyrimi 2 388 euro.
27. Detyrime të b/shortit ndaj shtetasit Julien Gerard Emilie Roche, për apartamentin në Kavajë, në shumën 20 000 euro.

28. Kredi e marrë nga kandidati dhe b/shorti në ISP Bank, për pasurinë truall dhe ndërtesë në Mjull-Bathore, Tiranë, në vlerën 300 000 euro, me gjendje detyrimi 286 782 euro.

Vlera e pasurisë bruto është 4 394 494 lekë + 669 656 euro, e konvertuar rreth 69 713 000 lekë dhe neto rreth 39 789 000 lekë.

Detyrimet e Kandidatit dhe të b/shortit janë deklaruar në shumën 306 782 euro, konvertuar rreth 29 924 000 lekë, që përbën detyrimet ndaj ISP Bank për kredinë e marrë, si dhe ndaj shtetasit Julien Roche për blerjen e apartamentit në Qerret, Kavajë.

Në vlerën totale të pasurisë nuk janë përfshirë detyrimet për shpenzime spitalore në shumën 217.026 euro, si dhe detyrimet e kartave të kreditit 2.388 lekë + 2.056 euro. Konvertuar me kursin e këmbimit valutor të Bankës së Shqipërisë datë 24.07.2025, ku 1 euro = 97.54 lekë.

11. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik” i ndryshuar, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, Ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Inspektorati i Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka konstatuar se për subjektin Pranvera Pustina:

- a) **deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;**
- b) **ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;**
- c) **nuk ka kryer fshehje të pasurisë;**
- d) **nuk ka kryer deklarim të rremë;**
- e) **kandidati nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.**

12. Me Shkresën nr. 2050 Prot, datë 17.07.2025, Këshilli i është drejtuar Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me kërkesë për informacion nëse, kandidatja Pranvera Pustina ka kryer transaksione apo disponon pasuri të dyshimta. Nëse po, është kërkuar të dërgohen pranë Këshillit, të dhënat si dhe dokumentacioni përkatës.

Në përgjigjen drejtuar Këshillit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka informuar se, nga kërkimi në sistemin elektronik lidhur me shtetasen Pranvera Pustina nuk rezulton raportim për transaksione bankare.

13. Me Shkresën nr. 2057 Prot, datë 17.07.2025, Këshilli i është drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit me kërkesë për informacion nëse, kandidatja Pranvera Pustina, rezulton e regjistruar si subjekt tregtar. Nëse po, është kërkuar të informohet Këshilli në lidhje me:

- *Të ardhurat e realizuara nga ky subjekt përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar aktivitetin, duke na dhënë informacion të saktë, lidhur me fitimin neto, për çdo vit të ushtrimit të aktivitetit;*

- *Na vini në dispozicion kopje të pasqyrave financiare dhe deklaratave të Tatimit të Thjeshtuar mbi Tatimin, TAPBV, apo të Tatim Fitimit, të dorëzuara nga subjekti, për periudhën nga fillimi i aktivitetit deri më sot.*

Në përgjigje, me Shkresën nr. 14658/1 Prot, datë 24.07.2025, Qendra Kombëtare e Biznesit ka informuar se, *pas verifikimeve të kryera, referuar të dhënave në sistemin informatik tatimor, shtetasja Pranvera Pustina, e datëlindjes 01.04.1986, lindur në Tepelenë, banuese në Tiranë, identifikuar me Nr. Personal 165401080F nuk figuron e pajisur me NIPT, si person fizik, juridik apo të zotërojë kuota/aksione në shoqëri tregtare të Regjistruara pranë Regjistrat Tregtar“.*

14. Me Shkresën nr. 2049 Prot, datë 17.07.2025, Këshilli i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) me kërkesë për informacion nëse, kandidatja Pranvera Pustina ka kryer veprime importi, eksporti apo kalimi tranzit të mallrave nga/në territorin e Republikës së Shqipërisë. Nëse po, është kërkuar të dërgohen pranë Këshillit, të dhënat si dhe dokumentacioni përkatës.

Në përgjigje, me Shkresën nr. 14577/1 Prot, datë 25.07.2025, të DPD është informuar se, pas verifikimit në sistemin informatik rezultoi se shtetasja Pranvera Pustina,

“- ka kryer në 1 (një) rast të vetëm praktikë doganore për zhdoganimin e një autoveturë nëpërmjet deklaratës doganore Im4 nr. R64435, datë 13.09.2013 të degës së doganës Muriqan“.

- Sa lidhet me informacionin që administrohet nga Drejtoria Antitrafik, “nuk rezultojnë të dhëna për deklarime për para CASH, çek, apo metale a sende të çmuara në pikat e kalimit kufitar, për shtetasin Pranvera Pustina, për periudhën Mars 2004 deri më datë 02 Mars 2025“.

15. Me Shkresën nr. 2048 Prot, datë 17.07.2025, Këshilli i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) me kërkesë për informacion nëse, kandidatja Pranvera Pustina rezulton e regjistruar si subjekt tregtar. Nëse po, është kërkuar të dërgohen pranë Këshillit, të dhënat si dhe dokumentacioni përkatës.

Në përgjigje, me Shkresën nr. 15015/1 Prot, datë 06.08.2025, të DPT është informuar se, pas verifikimit në sistemin informatik tatimor, shtetasja Pranvera Pustina *nuk rezulton i regjistruar si Person Fizik apo administrator/aksioner në ndonjë subjekt tregtar apo shërbimi i cili administrohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.*

16. Nga përgjigjet e ardhura nga këto institucione arrihet në përfundimin se, ka rezultuar përputhshmëri mes deklarimeve të kandidatës së kontrolluar znj. Pranvera Pustina, Raportit të përgatitur nga ILDKPKI-ja si dhe përgjigjeve të ardhura nga institucionet e mësipërme. Në këtë mënyrë, konkludohet se, nuk ka nevojë të kryhet një hetim më i thelluar se ai i kryer nga ILDKPKI-ja.

III- VERIFIKIMI I FIGURËS SË KANDIDATIT.

17. Për verifikimin figurës së kandidatës Pranvera Pustina, me Shkresën nr. 2059 Prot, datë 17.07.2025, Këshilli i është drejtuar Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe të gjitha Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm në Republikën e Shqipërisë, duke ju kërkuar informacion nëse, për kandidaten Pranvera Pustina kanë patur:

- *Të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm (lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin Nr.95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"), ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike;*

- *Materiale kallëzuese të mosfilluara, procedime penale të pushuara, pezulluara apo të dërguara për gjykim, ku kallëzimi ka qenë në ngarkim të kësaj shtetase.*

Nëse po, është kërkuar të përcillet pranë Këshillit, kopje e njehsuar me origjinalin e praktikës përkatëse. Nëse për kallëzime/procedime ka pasur ankime ose vendimmarrje nga gjykatat, është kërkuar të përcillen kopje të vendimeve të gjykatave deri në marrjen formë të prerë të tyre.

Në përgjigje, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me Shkresën nr. 2507 Prot. (D.B), datë 25.07.2025 "Dërgohet Informacion", bën me dije se "Nuk rezulton që në emër të shtetases së mëposhtme të jetë regjistruar ndonjë kallëzim apo procedim penal"

Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Berat, Gjirokastrë, Dibër, Korçë, Fier, Lezhë, Sarandë, Vlorë, Shkodër, Kukës, Elbasan, Dibër, kanë informuar përmes shkresave zyrtare respektive, në mënyrë të përmbledhur se: *"Për shtetasen Pranvera Pustina nuk disponojnë të dhëna, apo indicie të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese, të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm, apo materiale kallëzuese të mosfilluara, procedime penale të pushuara, pezulluara apo të dërguara për gjykim"*.

18. Me Shkresën nr. 2056. Prot, datë 17.07.2025, Këshilli i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me të cilën është kërkuar kontrolli i thelluar i të dhënave të pasqyruara në Formularin e Vetëdeklarimit të kandidatës Pranvera Pustina, me

qëllim verifikimin e saktësisë së të dhënave të pasqyruara, për të konstatuar nëse rrethanat janë të ndryshme dhe nëse kandidati është subjekt i ndalimeve sipas kriterëve të Ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i ndryshuar.

Në përgjigje, me Shkresën nr. 1113/3, datë 31.07.2025, Prokuroria e Përgjithshme informon se: *"Nga kontrolli në regjistrat e ankesave, nuk rezulton të ketë ankesë të depozituar pranë Prokurorisë së Përgjithshme ndaj prokurores Pranvera Pustina"*.

19. Me Shkresën nr. 2059. Prot, datë 17.07.2025, Këshilli i është drejtuar së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar.

Në përgjigje, me Shkresën nr. 1521/1 Prot, date 22.07.2025, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar informon se shtetasja Pranvera Pustina *"nuk rezulton të ketë marrë cilësinë si person nën hetim në një procedim penal, ndaj tij nuk është marrë vendim për të zbatuar/revokuar/shuar një masë sigurimi me karakter personal ose pasuror, ndaj tij nuk ka të dhëna për procedime penale të mos filluara, të pushuara apo të pezulluara, vendime dënimi apo pafajësie në të cilat përmendet emri i kandidatit në proces verifikimi"*.

20. Me Shkresën nr. 3029 Prot, datë 25.07.2025, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar informon se për shtetasen Pranvera Pustina *"nuk ka dhënë dënime penale"*.

RAPORTIMI NGA SHËRBIMET SHTETËRORE INFORMATIVE

21. Gjatë procedurës së verifikimit të figurës për kandidaten Pranvera Pustina iu kërkuar zyrtarisht informacion shërbimeve informative shtetërore.

22. Me Shkresën nr. 2058 Prot, datë 17.07.2025, të Këshillit drejtuar Shërbimit Informativ Shtetëror është kërkuar nëse, për kandidaten Pranvera Pustina disponohen:

- *Të dhëna apo indicje për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta;*
- *Të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm (lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr.95/2016 "Për organizim dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar") ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike.*

23. Me Shkresën nr. 2052 Prot, datë 17.07.2025, të Këshillit drejtuar Agjencisë Mbikëqyrjes Policore është kërkuar nëse për kandidaten Pranvera Pustina disponohen:

- *Të dhëna apo indicje për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta;*

- *Të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm (lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin Nr.95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar") ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike.*

24. Me Shkresën nr. 2050 Prot, datë 17.07.2025, të Këshillit drejtuar Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes pranë Ministrisë së Mbrojtjes është kërkuar nëse, për kandidaten Pranvera Pustina disponohen:

- *Të dhëna apo indicje për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta;*

- *Të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm (lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin Nr.95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar") ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike.*

Në përgjigje, me shkresat e dërguara nga Shërbimi Informativ Shtetëror, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore pranë Ministrisë së Brendshme dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, informohet se, për prokuroren Pranvera Pustina:

- *nuk disponohen të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme,*
- *nuk ka të dhëna apo indicje për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta,*
- *nuk ka të dhëna për veprimtari kriminale apo të ketë lidhje/kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar,*
- *nuk disponohen të dhëna/informacione për përfshirjen e tij në veprimtari që çënojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.*

IV- KUSHTE TË TJERA LIGJORE

25. Me qëllim verifikimin nëse, në ngarkim të kandidates Pranvera Pustina ka pasur procedim disiplinor, nëse po, cila ka qenë vendimmarrja përfundimtare për këtë

procedurë, nëse është administruar një kopje e dosjes personale pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Këshill.

Nga dokumentacioni i ndodhur dhe administruar në dosjen e kandidatit pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Këshill *"nuk rezulton që ajo të ketë qenë subjekt i ndonjë masë disiplinore nga titullarët e institucioneve ku ajo ka punuar" në sistemin e prokurorisë prej datës 15.10.2010 dhe në vijim."*

26. Kandidatja Pranvera Pustina, në vitin 2008 ka marrë titullin "Jurist" në Fakultetin e Drejtësisë. Duke iu referuar të dhënave të dosjes personale, konstatohet se në datë 10 Tetor 2010, me Dekret të Presidentit të Republikës znj. Pranvera Pustina është emëruar Prokuror në stazh, pranë Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me Dekretin tjetër me nr. 7161, date 16.11.2011, të Presidentit të Republikës është emëruar Prokuror në Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me Urdhërin nr. 254, datë 02.12.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, prokurori Pranvera Pustina është komanduar në të njëjtën detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, ku ka punuar deri me datë 09.10.2015, kohë kur është transferuar përsëri në Tiranë në të njëjtën detyrë.

Me Urdhërin Nr. 03/2, datë 18.02.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm ka kaluar në Njësinë e Hetimit të Korrupsionit dhe Pasurisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rrënda.

Me Vendimin nr. 254, date 12.12.2019, të Këshillit, prokurori Pranvera Pustina është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Me Vendimin nr. 06, datë 20.01.2020, të Këshillit, prokurori Pranvera Pustina është komanduar në pozicionin e ndihmësmagjistrates në Prokurorinë e Përgjithshme, për një afat prej 5 (pesë) vitesh. Me Urdhërin nr. 17, datë 24.01.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, prokurori është caktuar në detyrë e Drejtorit të Kabinetit të zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

27. Kandidatja ka eksperiencë si prokuror në Prokuroritë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Krujë, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rrënda, si ndihmësmagjistrate në Prokurorinë e Përgjithshme, dhe si magjistrate e komanduar në detyrën e Drejtorit të Kabinetit në Prokurorinë e Përgjithshme.
28. Kandidatja Pranvera Pustina i është nënshtruar Programeve të Formimit Vazhdues dhe trajnimeve në Shkollën e Magjistraturës, në Prokurorinë e Përgjithshme, USAID, etj, duke shprehur gatishmërinë e lartë për t'u rritur nga ana profesionale dhe menaxheriale. Në disa prej trajnimeve të Shkollës së Magjistraturës ka qenë në rolin e udhëheqësit/ lehtësuesit, në seminare me tema të ndryshme në të drejtën penale, në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, etj.

Gjithashtu, kandidatja Pranvera Pustina ka qenë e angazhuar dhe në veprimtari jashtë funksionit (mësimdhënie) në institucione arsimor universitare.

Pjesë e dosjes personale të kandidatës janë dokumente në vite të ndryshme gjatë karrierës si prokurore dhe jo vetëm, ç'ka flet për një angazhim të gjithanshëm personal në aktivitete profesionale, etiko morale, mësimore, etj, gjatë punës së saja si prokurore.

Pjesë e CV-së së saj janë angazhimet në një sërë projektesh e programesh shqiptare dhe të huaja për monitorimin e gjykatave dhe prokurorive kryesore të vendit në kuadër të projekteve monitoruese të sistemit të drejtësisë.

Kandidatja është njohëse shume e mirë e gjuhës Angleze dhe Italiane, gjithashtu përdor shumë mirë programet e ndryshme kompjuterike.

29. Për shkak të moshës nën 15 vjeç para datës 2 Korrik 1991, si datë fundore e zbatimit të Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli nuk i është drejtuar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për kandidaten Pranvera Pustina pasi nuk është subjekt verifikimi sipas përcaktimeve të këtij ligji.

30. Me Shkresën nr. 1587/19 prot (ex 24) datë 10.07.2025 “Dërgohet Raporti i Vlerësimit Etik dhe Profesional për Prokurorin e Komanduar në Prokurorinë e Përgjithshme, znj. Pranvera Pustina”, Prokurori i Përgjithshëm ka dërguar Raportin e vlerësimit me të cilin znj. Pranvera Pustina vlerësohet “Shkëlqyeshëm”.

Gjithashtu, në dosjen personale që ndodhet në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Këshillit, prokurorja Pranvera Pustina ka vlerësime etiko-profesionale “Shumë mirë” për vitet 2013, 2014 dhe 2016.

31. Me Vendimin nr. 165/2019 “Për miratimin e Raportit për analizimin e aftësive profesionale të prokurores Pranvera Pustina”, Këshilli ka miratuar Raportin e vlerësimit etik dhe profesional i cili i është dërguar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Me Vendimin nr. 308, nr. 180 Akti, datë 14.10.2020, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka konfirmuar në detyrë znj. Pranvera Pustina, prokuror/Drejtor i Kabinetit në Prokurorinë e Përgjithshme. Vendimi ka marrë formë të prerë pasi vendimi nuk u ankimua nga palët në datë 01.12.2020.

32. Relacioni me gjetjet e më sipërme paraprake iu përcoll për shqyrtim Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, bashkë me kërkesën që

Komisioni të vendosë miratimin e Relacionit dhe njoftimin e kandidates së verifikuar, znj. Pranvera Pustina mbi gjetjet paraprake, dhe marrjen e konfirmimit ose vërejtjeve nga ana e saj, nëse ka, në lidhje me gjetjet e këtij Relacioni, me qëllim vijimin e procedurës administrative.

33. Në datë 20.01.2026, pas miratimit në Komisionin e Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Relacioni me gjetjet paraprake në rrugë elektronike iu përcoll për njohje kandidates së verifikuar, znj. Pranvera Pustina, me qëllim vijimin e procedurës administrative.

34. Në rrugë elektronike, në datë 20.01.2026, kandidatja Pranvera Pustina konfirmoi marrjen e Relacionit dhe shprehu dakordësinë e saj pa vërejtje lidhur me gjetjet e miratuara nga Komisioni.

35. Në konkluzion, bazuar në nenet 32, pikat 2-7 dhe 48, pikat 7 dhe 8, Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikat 1, 2, 11 dhe 12, Seksioni B të Kreut VI, Rregullores, në nenin 9, pika 5, të Vendimit nr. 200, datë 23.09.2020, “Për miratimin e Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, i propozoi Këshillit:

- Të vlerësojë të përfunduar verifikimin e pasurisë dhe figurës së znj. Pranvera Pustina, kandidate për pozicionin e Prokurorit në Prokurorinë Përgjithshme, sipas përcaktimeve të nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Lejimin e kandidates, znj. Pranvera Pustina të vijojë procedurën e mëtejshme për emërim në pozicionin e Prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenet 32, pikat 2-7 dhe 48, pikat 7 dhe 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164, 166, dhe 189, pika 1, germa “a” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe në pikat 1, 2, 11 dhe 12, të Seksionit B, dhe pika 8, Seksioni Ç, të Kreut VI, të Vendimit nr. 171, datë 27.9.2019 “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, i ndryshuar, në nenin 9, pika 5, të Vendimit nr. 200, datë 23.09.2020, “Për miratimin e Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të vlerësojë të përfunduar verifikimin e pasurisë dhe figurës të prokurorit Pranvera Pustina, kandidate për Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.
2. Të lejojë prokurorin Pranvera Pustina të vijojë procedurën e mëtejshme për emërim në pozicionin e Prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme.
3. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Pranvera Pustina.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 29.01.2026.



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Vatë Staka

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Olger Eminaj

ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Erind Merkuri